

VENDIM
Nr.398, datë 8.9.1992

PËR NJË SHITESË NË UDHËZIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.4, DATË 31.7.1992 "PËR KRITERET E PËRGJITHSHME TË MBAJTJES NË PUNË TË PUNONJËSVE GJATË ZBATIMIT TË LIGJIT NR.7521, DATË 30.10.1991 "PËR PËRKRAHJEN SOCIALE TË PERSONAVE QË DALIN TË PAPUNË NGA ZBATIMI I REFORMËS EKONOMIKE, NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.7559, DATË 2.7.1992"

Me propozimin e Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të Përndjekurve Politikë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr.4, datë 31.7.1992, pika 7 ndryshohet si vijon:
"Personat juridikë shtetërorë që kanë të punësuar invalidë, t'u japin këtyre përparësi të veçantë në mbajtjen në marrëdhënie pune.

Personat juridikë shtetërorë, sipas mundësive të tyre ekonomike e financiare, të përpiqen të mbajnë në marrëdhënie pune gratë shtatzëna dhe të rinjtë pa prindër".

Ky vendim në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi